



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE

Bregu i Diellit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
 Tel: +381 38 552 126 ext.101 • E-mail: fim@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 1274

Date: 10/09/2024

- Për: **Këshillin e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike**

- Nga: **Komisioni për Ankesa dhe Parashtresa**

- Lënda: Shqyrtimi i ankesave të kandidatëve në lidhje me Konkursin Plotësues për Angazhim të Bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime në bazë të nevojave të njësive akademike të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", për vitin akademik 2023-24 me Nr. Prot: 2/426 i datës 25.07.2024, pika IX për Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, respektivisht pozitat 11.

RAPORT

Nga Administrata e FIM Komisioni ka pranuar një ankesë në vendimin e Komisionit vlerësues të Konkursit për Angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime në bazë të nevojave të njësive akademike të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", për vitin akademik 2024-25 me Nr. Prot: 2/426 i datës 25.07.2024, respektivisht pozita 11 (Tre bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët e komunikacionit (BSC dhe MSC).

Në takimin e mbajtur me 10.09.2024, Komisioni për ankesa dhe parashtresa ka shqyrtuar ankesën e kandidatit Shaban Thaqi.

1. **Ankesa e kandidatit Shaban Thaqi** me nr. Protokolli 08. 1261 e datës 06. 09. 2024, e dorëzuar në FIM dhe që lidhet me pozitën 11 të konkursit.

Kandidati Shaban Thaqi në ankesën me Nr. 08. 1261 të datës 06. 09. 2024 pretendimet kryesore i ka:

- Pretendon se në raportin e komisionit vlerësues të datës 30.08.2024 kandidatit Armen Musliu i është shënuar në tabelën e përvojës së punës 4 vite, ndërsa të njëjtit kandidat nga komisioni tjetër brenda të njëjtit konkurs dhe institucion i është vlerësuar përvoja 0 (zero) vite.
- Në anën tjetër si përvojë profesionale në fushën e ngushtë i është vlerësuar aktiviteti në pompën e derivateve Lab-Oil.
- Nuk i është marrë parasysh dhe vlerësuar fare projekti shkencor ndërkombëtar i cili është fituar në një kompeticion ndërkombëtar **RCC-Western Balkans-founded by European Union**), i cili njëherit paraqet kontribut për fakultetin.

- Nuk është marrë parasysh mobiliteti në CEEPUS ku është prezantuar edhe projekti si punë shkencore.

Komisionit i ankesave bazuar në dokumentet e ofruara nga kandidatet dhe pretendimet sipas ankesës së paraqitur jep këto konstatime:

- Komisioni vlerësues brenda FIM-së për pozitën nr. 9, për kandidatin Armend Musliu ka vlerësuar në tabelën përmbledhëse të kandidateve (përvoja e punës në fushën përkatëse-vitet) 0 (zero) vite.
- Komisioni vlerësues brenda FIM-së për pozitën nr. 11, për kandidatin Armend Musliu ka vlerësuar në tabelën përmbledhëse të kandidateve (përvoja e punës në fushën përkatëse-vitet) 4 vite.
- Nga dokumentacioni i ofruar kandidati Armend Musliu posedon dëshmi të lëshuar nga BKS (vërtetim) dhe nga Lab-Oil Sh.p.k. (vërtetim) (BKS – 01.01.2020-31.12.2020, Lab-Oil – 03.04.2021-vijon). Kandidati Armend Musliu sipas përshkrimit në vërtetim në BKS ka punuar si Likuidator teknik në departamentin Juridik dhe dëme, ndërsa në Lab-Oil sipas përshkrimit në vërtetim është i punësuar nga data 03.04.2021 me kontratë të rregullt, por nuk përshkruhet funksioni i punës.
- Kandidati Shaban Thaqi posedon dëshmi (letër reference nga Trafiks Sh.p.k.) që është i punësuar prej 01.11.2021 si inxhinier i komunikacionit. Poashtu, ka ofruar letër reference që ka qenë i angazhuar gjatë viteve 2022-2023 në kuadër të grupit të studenteve nga Instituti për shkencë dhe teknologji Insi për hartimin e planeve të mobilitetit.
- Kandidati Shaban Thaqi ka ofruar dëshmi për pjesëmarrje në projektin shkencor RCC-Western Balkans- founded by European Union i cili është zhvilluar brenda FIM në fushën “Smarten up for the future”.
- Kandidati Shaban Thaqi ka ofruar dëshmi që ka marrë pjesë në programin CEEPUS nga data 24.06.2024-30.06.2024.

Komisioni i ankesave duke u bazuar në pikat e përshkuara më sipër jep këtë mendim:

- Asnjëri nga kandidatet nuk ka ofruar dëshmi për përvojë pune në arsimin e lartë.
- Kandidatit Shaban Thaqi kam marr pjesë ne projektin shkencor **RCC-Western Balkans- founded by European Union** i cili është zhvilluar brenda FIM ne fushën “Smarten up for the future”.

Prandaj, këshilli i FIM-se duke pas parasysh konstatimet dhe mendimin e komisionit të ankesave dhe rolin vendimmarrës, komisioni konsideron se i mbetet Këshilli të FIM-së vendimmarrja përfundimtare.

Prishtinë, 10.09.2024

Komisioni për ankesa dhe parashtresa

1. Prof. dr. Naser Lajqi

2. Prof. ass. Riad Ramadani

3. Prof. ass. Gëzim Hoxha
